



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SHITES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Arsim,
Uprava za Obrazovanje /Department of Education.

Nr i Prot 05/339

Datë: 14.07.2021

Bazuar në Rregulloren Komunale për Ndarjen e Bursave për Studentë me Nr 06/570-60 e datës 30.03.2012 me ndryshimet sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.01-06/570-60 të datës 31.03.2021, në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës së Shtimes për caktimin e shumëve për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2020/2021 për vitin fiskal 2021, me nr. të protokollit 02/259 të datës 09.06.2021 dhe në bazë të rekomandimit të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport me nr. prot. 01/174 të datës 24.06.2021, Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime shpall:

KONKURS
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË SHITES
PËR VITIN AKADEMIK 2020/2021

Komuna e Shtimes ndanë 24 bursa për studentë, që studiojnë në ndonjë fakultet në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit publik dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë, që janë të akredituar, për vitin akademik 2020/2021.

1. Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore – 3 studentë, (Matematikë-2 student), (Kimi, Biologji, Fizikë etj.-1 student),
2. Fakulteti i Mjekësisë – 4 studentë, (Mjekësi e përgjithshme – 3 studentë), (Stomatologji, Farmaci, Infermieri etj. -1 studentë),
3. Fakulteti i Makinerisë – 2 studentë,
4. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – 2 studentë,
5. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës – 2 studentë,
6. Fakulteti i Arteve – 1 studentë,
7. Fakulteti i Shkencave Sportive – 1 studentë,
8. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës 1 studentë,
9. Fakulteti Filozofik – 1 studentë,
10. Fakulteti Filologjik – 1 studentë,
11. Fakulteti i Edukimit – 1 studentë,
12. Fakulteti Juridik – 1 studentë,
13. Fakulteti Ekonomik – 1 studentë,
14. Nga tre studentët e përcaktuar shkojnë për fëmijët e dëshmorëve, e nëse nuk ka fëmijë të dëshmorëve studentë atëherë ndahen në fakultetet deficitare, (Mjekësi, FIEK, FNA),
15. Nëse në njërin prej fakulteteve të përcaktuar nuk ka asnjë aplikant ose nuk e mbërrin plotësimin e kushtit të mesatares atëherë shkojnë në drejtimin deficitarë, (Mjekësi, Shkenca Kompjuterike, Makineri)

Bursat do të ndahen për 10 (dhjetë) muaj dhe shuma mujore do të jetë 50 €
Studentët të cilët janë përfitues të bursës në vitin akademik 2019/2020 nga konkursi
paraprak janë të obliguar të riaplikojnë.

KRITERET

- I. Kuadri defëitar në komunën e Shtimes
- II. Suksesi më i mirë i studentit
- III. Gjendja e vështirë sociale
- IV. Student i rregullt i ndonjërit prej Fakulteteve në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit publik dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë, që janë të akredituar.

Në numrin rendor –I- Përparësi do të kenë:

1. Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore
2. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.
3. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike.
4. Fakulteti i Mjekësisë
5. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës
6. Fakulteti i Edukimit - Programi Fillor

Në numrin rendor –II-, Përparësi do të kenë:

1. Suksesi (Nota mesatare, 7 e më lart)
2. Studentët e rregullt që kanë të mbaruar vitin e parë të studimeve.

Në numrin rendor –III-, Përparësi do të kenë:

1. Gjendja më e rëndë sociale
2. Në kushtet e njëjta për pikat I,II,III dhe IV përparësi do të kenë:

- a) Studenti-ja, fëmijë i invalidit të luftës
- b) Studenti-ja, fëmijë i veteranit të luftës,
- c) Studenti-ja. Fëmijë i martirit-es së luftës.
- d) Studenti-ja, me gjendje të rëndë sociale,
- e) Studenti-ja, që është me aftësi të kufizuara,
- f) Studenti-ja , pa prind ose në mbikëqyrje të nënës,
- g) Studenti i prindit të burgosur politik,
- h) Studenti që ka fituar shpërblim kombëtar ose ndërkombëtar në lëmin e arsimit.

Për t'gjitha këto kategori gjatë aplikimit duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat dhe institucionet përkatëse.

Në numrin rendor –IV-, Përparësi do të kenë

1. Student i rregullt i ndonjërit prej Fakulteteve në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit publik dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë, që janë të akredituar
2. Studenti-ja banor-rezident i komunës së Shtimes.
3. Studenti-ja, i cili ka dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak

DOKUMENTACIONI QË KËRKOHET PËR KONKURIM:

1. Kërkesa (Aplikacioni) sipas formës së Komunës,
2. Kopja e letërnjoftimit
3. Kopja e indeksit, apo ID-kartelës
4. Certifikata e notave dhe vërtetimi për statusin e studentit (original)
5. Certifikatën mbi vendbanimin e përhershëm,
6. Vërtetimi që studenti nuk është përfutës i bursës universitare.

Fëmijëve të dëshmorëve u ndahen bursat me automatizëm nga viti i parë i studimeve, por në rast të përsëritjes së vitit, studenti e humb të drejtën për bursë;

Të drejtën në bursë studenti përsëri mund ta shfrytëzon vetëm pas dorëzimit të dëshmisë për regjistrimin e vitit vijues të studimeve në njërin fakultet.

Komisioni Komunal për ndarjen e bursave do të bëjë përzgjedhjen e studentëve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë konkurs dhe konform Rregullores Komunale për Ndarjen e Bursave për Studentë të Komunës së Shtimes.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen të kompletuara sipas kërkesës me këtë konkurs në Drejtorinë Komunale të Arsimit, Kati i III-të, në ndërtesën e Komunës së Shtimes.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë prej ditës së shpalljes në web-faqen zyrtare të Komunës së Shtimes dhe tabelën e shpalljeve të Komunës.

Drejtoreshë e Arsimit:
Agime Hasani Roshaj

